



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

34,37/20

Date/Datum. 26.02.2020

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.34/20

37/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NNP “ELEKTRO” dhe OE: N.SH. “MVR Elektromontues”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: NNP “Toni”-Drenas, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” me nr. prokurimit: 644-19-7674-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, më datë: 12.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatoreve ekonomik: NNP “ELEKTRO” dhe OE: N.SH. “MVR Elektromontues”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” me nr. prokurimit: 644-19-7674-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri,

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” me nr. prokurimit: 644-19-7674-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **15** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatoreve ekonomik ankues: "ELEKTRO" dhe OE: N.SH. "MVR Elektromontues" - Prishtinë aprovohen si pjesërisht te bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues NNP "ELEKTRO", si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.01.2020 me nr 34/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra" me nr. prokurimit: 644-19-7674-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 60, 61, 69.4 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues N.SH. "MVR Elektromontues"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.01.2020 me nr 37/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra" me nr. prokurimit: 644-19-7674-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 52, 59, 60, 61 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren B57 lidhur me trajtimin e çmimeve jo-normalisht të ulëta

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.01.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 03.02.2020 sqaron si në vijim,

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES NNP“ELEKTRO”- VUSHTRI

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP “Elektro”, se AK gjate fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.N.P “Toni” edhe pse çmimet e ofruara nga ky operator në shume pozicione janë jashtëzakonisht të ulëta, duke ofruar një tabelë të pozicioneve me çmime jo-normalisht të ulëta dhe sipas OE ankues oferta e OE të rekomanduar për kontratë duhet të shpallej e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit AK ka zbatuar procedurën e çmimit për njësi sipas peshimit duke i klasifikuar pozicionet e shërbimeve në tri kategori.

Nga oferta e OE të rekomanduar për kontratë N.N.P “Toni” është evidente që ky OE në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe në disa pozicione edhe çmime jo-normalisht të larta në krahasim me çmimet e tregut.

AK bazuar në nenin 61 të LPP-së, me datë 11.12.2019 ka kërkuar informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët nga OE i rekomanduar për kontratë duke kërkuar informata për një numër të madh të pozicioneve lidhur me çmimet e ofruara nga ky OE.

Me datë 12.12.2019 OE i rekomanduar për kontratë përmes përgjigjes në sqarimin e çmimeve për pozicionet e kërkuara konfirmon se i qëndron çmimeve të vendosura në ofertën e tyre duke siguruar që shumicën e artikujve për këto pozicione i ka në stok(rezerva) të cilat kane mbet nga projektet tjera.

Për ekspertin shqyrtues informatat/sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë bindëse dhe nuk janë konform nenit 61 të LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët).

Më poshtë po i listoj disa pozicione që në dukje janë çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë informatë/sqarim për këto pozicione.

Pozicioni 10 i kategorisë A “Porosia dhe montimi i relesë IC ASTRO Shnider, Siemens, ABB ose e ngjashme ekuivalent” që nga OE i rekomanduar për kontratë është ofruar me 0.50 €,ndërsa nga analiza e paramasës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 110.00 €.

Pozicioni 9 i kategorisë B” Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m,sipas porosisë së organit mbikëqyrës” që nga OE i rekomanduar për kontratë është ofruar me 10.00 €,ndërsa nga analiza e paramasës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 90.00 €.

Pozicioni 14 i kategorisë C “Punimi i bazamentit për shtylla të metalit prej betonit MB 30 me bulona dhe material tjetër të nevojshëm. (0.80x0.80x0.80)m. komplet” që nga OE i rekomanduar për kontratë është ofruar me 0.50 €, ndërsa nga analiza e paramasës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej

130.00 €.

Sipas ekspertit shqyrtues OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur ekonominë e procesit të prodhimit, fatura të furnizimeve, apo edhe dëshmi tjera siç e përcakton neni 61 i LPP-së. Konsideroj që pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe AK nuk e ka zbatuar drejt neni 61 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Sa i përket pretendimit tjetër se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një certifikatë ISO 9001-2015 e cila nuk mund të vërtetohet apo është e manipuluar, eksperti shqyrtues sqaron se certifikata e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë ISO 9001-2015 ka paqartësi lidhur me datën e validitetit. Në certifikatën e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me numër KC170547 ka të shënuar datën e lëshimit të fundit të certifikatës që është 18.05.2017, data e mbarimit të certifikatës 17.05.2018 dhe data përfundimtare e certifikatës që është 17.05.2020 dhe është e paqarte se cila është data e validitetit të certifikatës.

Sa i përket vërtetësisë së certifikatës të pretenduar nga OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se ka hulumtuar në internet në faqen KingCert si lëshues i kësaj certifikate dhe nuk ka ndonjë dëshmi për certifikatën nr.KC170547. Gjithsesi AK konform neni 59 dhe 72 të LPP-së ka mundur të kërkojë sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me validitetin e certifikatës apo edhe vërtetësinë e kësaj certifikate.

Pretendimi ankimor është i pjesërisht i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES N.SH“MVR ELEKTROMONTUES” -PRISHTINË

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.SH“MVR Elektromontues”, se AK gjate fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe në të njëjtën kohë duke favorizuar rekomandon për kontratë ofertën e OE N.N.P “Toni” e cila ka ofruar çmime spekulative/ manipuluese, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Nga oferta e dorëzuar e OE ankues N.SH“MVR Elektromontues” është e evidente që ky OE në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta (shumë pozicione janë me çmim 0.10 €) dhe në disa pozicione edhe çmime jo-normalisht të larta në krahasim me çmimet e tregut.

AK bazuar në neni 61 të LPP-së, me datë 11.12.2019 ka kërkuar informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët duke kërkuar informata për një numër të madh të pozicioneve të listuara në tabele lidhur me çmimet e

ofruara nga ky OE.

Me datë 12.12.2019 OE N.SH”MVR Elektromontues” përmes përgjigjes në sqarimin e çmimeve për pozicionet e kërkuara konfirmon se qëndron prapa çmimeve të ofruara duke ofruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë “Elektring” Shpk-Ferizaj e cila deklaron se N.SH”MVR Elektromontues” ka ofertuar me çmimet bazuar në ofertën paraprake të bërë nga kompania “Elektring” Shpk.

Për ekspertin shqyrtues informatat/sqarimet e dhëna nga OE N.SH”MVR Elektromontues” nuk janë bindëse dhe nuk janë konform neni 61 të LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët).

Marrëveshja dhe deklarata e prezantuar nuk ofrojnë ndonjë dëshmi bindëse për artikujt e ofruar me 0.10 €, dhe në këtë marrëveshje nuk ka ndonjë listë të çmimeve të ofruara as edhe ndonjë analizë lidhur me ekonominë e procesit të prodhimit, fatura të furnizimeve, apo edhe dëshmi tjera siç e përcakton neni 61 i LPP-së.

Më poshtë po i listoj disa pozicione që në dukje janë çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe OE N.SH”MVR Elektromontues” nuk ka dhënë asnjë informatë/sqarim për këto pozicione.

Pozicioni 10 i kategorisë A “Porosia dhe montimi i rele së IC ASTRO Shnider, Siemens, ABB ose e ngjashme ekuivalent” që nga OE N.SH”MVR Elektromontues” është ofruar me 0.10€, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 110.00 €.

Pozicioni 4 i kategorisë B “Furnizimi dhe montimi I trupit ndriçues REMO 400 me gjashtë poça GX 53 për montim në shesh të njëjta me ato ekzistuese” që nga OE N.SH”MVR Elektromontues” është ofruar me 0.10 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 190.00 €.

Pozicioni 9 i kategorisë B” Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m, sipas porosisë së organit mbikëqyrës” që nga OE N.SH”MVR Elektromontues” është ofruar me 1.00 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 90.00 €.

Konsideroj që pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër se AK për arsye të njëjta ka vepruar ndryshe lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta me OE të rekomanduar për kontratë, eksperti shqyrtues sqaron se për këtë pretendim është dhënë një përgjigje më lartë në pretendimin e operatorit tjetër ankues dhe ky pretendim konsideroj që është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se AK nuk ka zbatuar drejt neni 61- (Tenderët jo-Normalisht të Ulët) ku sipas OE ankues tek procedura e poentimit sipas çmimit për njësi nuk duhet të aplikohet neni 61 i LPP-së dhe as Rregullorja B57 për çmimet jo-normalisht të ulëta, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Pretendimi i OE ankues se neni 61 i LPP-së nuk duhet të aplikohet tek procedura e çmimit për njësi sipas

peshimit duke u thirrur në nenin 18.28 të RRUOPP-së duke cituar” Kurdo që Autoriteti Kontraktues nuk dine sasishtë e indikative, **kontratat me çmime për njësi**, AK duhet të përcaktoj peshën në bazë të rëndësisë se secilës” kategori të shërbimeve” ose secilit ”artikull” ose ‘grup të artikujve) në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit, **si psh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj.”**

Konsideroj që citimi i këtij neni të RRUOPP-së nga OE ankues është jo adekuat dhe nuk ka të bëjë me çmimet jo-normalisht të ulëta. Zbatimi i nenit 61 të LPP-së nuk kufizohet për ndonjë procedurë të caktuar të prokurimit por sipas pikës 1.të nenit 61 të LPP-së zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit citoj: Nëse një operator ekonomike dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim:(i)një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe(ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2.të këtij neni”.

Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues **të aprovohen pjesërisht të bazuara**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Operatori ekonomik (NNP “ELEKTRO”) përmes parashtrësës me shkrim të datës 03.01.2020 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik (N.SH. “MVR Elektromontues”-Prishtinë) përmes parashtrësës me shkrim të datës 06.02.2020 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtrësës me shkrim të datës 05.01.2020 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 12.02.2020, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankues , përfaqësuesit e AK-së si dhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrësat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së (NNP "ELEKTRO") ankues z. Salihu deklaroi: Ne kemi dhënë përgjigje edhe ne raport te ekspertizës, ne si OE mbetemi edhe me tutje pran ankese dhe pretendimeve tona ankimore te dhëne ne ankese, gjithashtu pajtohemi ne tërësi me raportin e Eksperti Shqyrtues te datës 03.02.2020 i cili raport përgjithësisht ka vërtetuar pretendimet tona ankimore përkitazi me këtë AP dhe shkeljet ligjore te cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues lidhur me këtë AP.

Gjithashtu me qellim te vërtetimit te pretendimeve tona kompania qe përfaqësoj unë me qellim te vërtetimit te çmimeve te tregut për disa artikuj te cilët jo vetëm e janë me çmime jo abnormalisht te ulëta njëkohësisht janë çmime manipulative ku vet prodhuesit e këtyre pajisjeve kanë dhënë çmime me shkrim ku për këta artikuj OE i rekomandua për kontrate ka ofruar çmime nga 10 cent 1 euro e 2 euro, ndërsa prodhuesit na kanë ofruar çmime ku këta artikuj ne treg te lire variojnë nga 150 euro deri 200 euro (provat ia dorëzoi panelit shqyrtues ku edhe Eksperti Shqyrtues i ka aprovuar). Gjithashtu dua te shtoj se ne si kompani me datën 22.01.2020 ju kemi drejtuar lëshuesit te certifikatës KING CERT lidhur me ISO Standardet me qellim te verifikimit se a eshte kjo Certifikatë Origjinale apo është e Falsifikuar, mirëpo lëshuesi i kësaj certifikate nuk ka dhënë kurrfarë përgjigje, gjithashtu kemi provuar ne faqe te Internetit por askund nuk figuron kjo certifikate e lëshuar nga kjo kompani, kjo mund te jete e falsifikuar (panelit i dorëzoi provën lidhur me këtë certifikate), po te ishte e njëjta origjinal do te kishte drejtpërdrejt akses ne internet.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së (N.SH. "MVR Elektromontues"-Prishtinë) z. Vitia i cili deklaroi: Përshëndetje te gjithëve, ia dorëzoi panelit shqyrtues fjalën me shkrim për këtë seance e qe do të jete pjese e procesverbalit.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesi i AK-së z. Dallku deklaroi: Ne si Autoriteti Kontraktues nuk jemi pajtuar me ekspertizën e Eksperti Shqyrtues për faktin se ne konsiderojmë dhe vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ne perpikëmeri nenin 61 te LPP-së lidhur me nenin 3.2 te RRUOPP-së ne pajtim me nenin 3.2 , Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga OE MVR , nga NNP Toni dhe nga OE NNP Elektro qe te japin sqarime dhe elementet e bezes se tenderit te tyre duke marr parasysh gjatë vlerësimit te tenderit ka gjetur se te 3 OE-te jo ne mase te barabarte por kanë dhënë çmime ku sipas komisionit vlerësues kanë qenë çmime jonormalisht te ulëta. Ne përgjigje te tyre OE-te kanë dhënë shpjegime përfaqësisht te njëjta te cilat Autoriteti Kontraktues i ka vlerësuar nje nga një. Sa i përket pretendimeve ankimore dhe vlerësimit te çmimit te OE MVR Elektromontues qe ka dal me çmimin me te ulet te çmimit te peshuar për njësi ne shpjegimet tone i kemi dhënë ne arsyetimin për eliminim te këtij OE arsyeja bazë ka qene 70% te çmimeve te OE rezultojnë te jene 10 Cent dhe mbetet ne verdiktin e OSHP-së a mund te konsiderohet

çmim serioz çmimi 10 Cent, kemi marr vendim ta eliminojmë këtë OE sepse shpjegimet e tij nuk kanë qenë bindëse për Autoriteti Kontraktues.

Sa i përket Ofertës te OE Toni ashtu siç theksuam edhe ky OE është vlerësuar se ka çmime jonormalisht te ulët ne ofertën e tij për atë arsye ka kërkuar shpjegime siç theksuam me lartë por që e bën dallimin nga Oferta e pare sepse nuk ka rezultuar se çmimet janë jashtëzakonisht te ultë ashtu siç komisioni i vlerësimit ka gjetur tek oferta e pare, megjithatë Autoriteti Kontraktues ne pajtim me dispozitat ligjore te LPP-së e ka kërkuar nga OE NNP TONI rritjen e sigurimit te ekzekutimit ne rast se rekomandohet nga 10 ne 25% gjë te cilën OE e ka pranuar dhe ky fakt nuk është cekur ne raportin e ekspertizës, ndoshta Eksperti Shqyrtues nuk e ka vërejt apo nuk e ka pare te rëndësishme, unë konsideroj se është relevante kjo për panelin shqyrtues, mbi këtë bazë marr parasysh se OE gjatë 3 viteve te fundit ka pasur kontrata me Autoriteti Kontraktues dhe përmbushjen e kontratës nuk ka pasur ndonjë vërejtje gjatë ekzekutimit te kontratës andaj edhe këtë element Autoriteti Kontraktues e ka marr për bazë kur ka vendosur ta rekomandoj për dhënie te kontratës.

Sa i përket Ofertës se NNP Elektro – gjithashtu AK ka vlerësuar se Oferta ka çmime jonormalisht te ulëta për çka ka kërkuar shpjegime, Autoriteti Kontraktues i ka marr për bazë shpjegimet dhe e ka radhitur ne mesin e OE-ve te përgjegjshëm por duke marr parasysh kriterin e dhënies se kontratës që ka qenë Tender i përgjegjshëm me çmim me te ulët është radhitur si tenderues i pasuksesshëm siç janë radhitur edhe OE-te tjerë me radhë sipas raportit te hapjes se vlerësimit.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Papaj deklaroj: Fillimisht ju sqaroj lidhur me këtë e AP ka qenë 2 Ankesa, OE MVR është me e lire dukshëm.

Filloj me Ankesën e OE “Elektro”, se OE i shpallur fitues se ka ofruar me çmime jonormalisht te ultë, Eksperti Shqyrtues sqaron se oferta e OE Toni shumica e pozicioneve janë me çmime manipuluese i ceku 3 pozicione , një krahasim psh; Poz. 14, Autoriteti Kontraktues e ka paraparë me 130 euro, ndërsa OE e ka ofruar 0.50 cent., Tek Poz. Nr 9. AK ka kërkuar sqarime nga OE por sqarimi ka qenë se ata i kanë ne stok, për mua është me rëndësi që Autoriteti Kontraktues nuk e ka shitur nenin 7. Sa i përket Certifikate 9001/2015 OE i shpallur fitues e ka ofrua një certifikate jo me data te qarta mbarimi i certifikate 17.05.2018 unë kam hulumtua ne faqen e KING CERT dhe nuk ka dëshmi që kjo Certifikate është valide është dashtë te kërkohet sqarime nga OE.

Sa i prekët OE te par Elektro montues edhe ata shihet se kanë ofruar shumicën e çmimeve me 0.10 cent, sqarimet e kërkuara nga AK nuk janë bindëse.

Sa i përket se neni 61 nuk zbatohet ku është hir ne nenin 18.28 te RRUOPP-së konsideroj qe ky nen nuk është adekuat dhe nuk ka te bej me nenin 61 te LPP-së.

Mbetem prapa raportit te dhëne ne ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së (NNP "ELEKTRO") ankuese z. Salihu deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe ankesën tone ta aprovoj si te bazuar dhe këtë AP ta kthej ne Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së (N.SH. "MVR Elektromontues"-Prishtinë) ankuese z. Vitia deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues pas verifikimeve qe ne i dorëzuam te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Dallku deklaroj: Kërkojmë qe Paneli shqyrtues te merr vendim te refuzoj ankesat e OE-ve si te pa bazuara dhe te vërtetoj vendimin e Autoritetit Kontraktues si te bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "Elektro", se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.N.P "Toni" edhe pse çmimet e ofruara nga ky operator në shume pozicione janë jashtëzakonisht të ulëta, duke ofruar një tabelë të pozicioneve me çmime jo-normalisht të ulëta dhe sipas OE ankues oferta e OE të rekomanduar për kontratë duhet të shpallej e papërgjegjshme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se AK ka zbatuar procedurën e çmimit për njësi sipas peshimit duke i klasifikuar pozicionet e shërbimeve në tri kategori. Nga oferta e OE të rekomanduar për kontratë N.N.P "Toni" është evidente që ky OE në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe në disa pozicione edhe çmime jo-normalisht të larta në krahasim me çmimet e tregut.

AK bazuar në nenin 61 të LPP-së, me datë 11.12.2019 ka kërkuar informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët nga OE i rekomanduar për kontratë duke kërkuar informata për një numër të madh të pozicioneve lidhur me çmimet e ofruara nga ky OE. Me datë 12.12.2019 OE i rekomanduar për kontratë përmes përgjigjes në sqarimin e çmimeve për pozicionet e kërkuara konfirmon se i qëndron çmimeve të

vendosura në ofertën e tyre duke siguruar që shumicën e artikujve për këto pozicione i ka në stok (rezerva) të cilat kanë mbet nga projektet tjera. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se informatat/sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë bindëse dhe nuk janë konform nenit 61 të LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët), sepse OE nuk ka dhënë informata/sqarime për pozicionet si:

- Pozicioni 10 i kategorisë A “Porosia dhe montimi i rele së IC ASTRO Shneider, Siemens, ABB ose e ngjashme ekuivalent” që nga OE i rekomanduar për kontratë është ofruar me 0.50 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 110.00 €.
- Pozicioni 9 i kategorisë B “Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m, sipas porosisë së organit mbikëqyrës” që nga OE i rekomanduar për kontratë është ofruar me 10.00 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 90.00€.
- Pozicioni 14 i kategorisë C “Punimi i bazamentit për shtylla të metalit prej betonit MB 30 me bulona dhe material tjetër të nevojshëm. (0.80x0.80x0.80)m. komplet” që nga OE i rekomanduar për kontratë është ofruar me 0.50€, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 130.00€.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur ekonominë e procesit të prodhimitarisë, fatura të furnizimeve, apo edhe dëshmi tjera siç e përcakton neni 61 i LPP-së por Paneli Shqyrtues sqaron për këtë pike pretenduese kemi vendimin e OSHP-se, vendimin PSH nr.590/19 te datës 13.11.2019 i cili nder te tjera sqaron se kur kemi kriterin çmimi me i lire i poentuar duhet te eliminohet nga praktika kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e një ofertuesi tjetër, pasi qe kriteri i tille kërkon qe çmimet e poentuara te bazohen ne çmimet e ofruara, e jo duke u bazuar me çmimet e ofertuesve te tjerë, sepse ne rast se kemi te bejme me krahasimin e cmimeve te ofertave te ndryshme me njera tjeteren atehere kemi te bejme me kriterin çmimi me i ulet dhe gjen zbatim rregullorja per tenderet jonormalisht te ulete. Paneli shqyrtues sqaron se Neni 52 .6 i LPP-se përcakton: Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, **çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.**

Paneli shqyrtues sqaron se ne rastin e kriterit çmimi me i lire i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimi me cmime pasi qe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga

raportet sipas peshës së dhënë. P.sh nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-ës, kjo në baze të interpretimit të KRPP-së të datës 10.12.2019 tek pyetjet e shpeshta, pyetja nr. 68. **Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "Elektro", se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një certifikatë ISO 9001-2015 e cila nuk mund të vërtetohet apo është e manipuluar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se certifikata e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë ISO 9001-2015 ka paqartësi lidhur me datën e validitetit. Në certifikatën e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me numër KC170547 ka të shënuar datën e lëshimit të fundit të certifikatës që është 18.05.2017, data e mbarimit të certifikatës 17.05.2018 dhe data përfundimtare e certifikatës që është 17.05.2020, dhe është e paqartë se cila është data e validitetit të certifikatës. Sa i përket vërtetësisë së certifikatës të pretenduar nga OE ankues, Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti profesional i prokurimit ka hulumtuar në internet në faqen KingCert si lëshues i kësaj certifikate dhe nuk ka ndonjë dëshmi për certifikatën nr.KC170547. Gjithsesi, AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së ka mundur të kërkojë sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me validitetin e certifikatës apo edhe vërtetësinë e kësaj certifikate. **Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.SH "MVR Elektromontues", se AK gjatë fazës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe në të njëjtën kohë duke favorizuar rekomandon për kontratë ofertën e OE N.N.P "Toni" e cila ka ofruar çmime spekulative/ manipuluese. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se nga oferta e dorëzuar e OE ankues N.SH "MVR Elektromontues" është e evidente që ky OE në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta (shumë pozicione janë me çmim 0.10 €) dhe në disa pozicione edhe çmime jo-normalisht të larta në krahasim me çmimet e tregut. AK bazuar në nenin 61 të LPP-së, me datë 11.12.2019 ka kërkuar informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët duke kërkuar informata për një numër të madh të pozicioneve të listuara në tabelë lidhur me çmimet e ofruara nga ky OE. Me datë 12.12.2019 OE N.SH "MVR Elektromontues" përmes përgjigjes në sqarimin e çmimeve për pozicionet e kërkuara konfirmon se qëndron prapa çmimeve të ofruara duke ofruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë "Elektring" Shpk - Ferizaj e cila deklaron se N.SH "MVR Elektromontues" ka ofertuar me

Faqe 11 nga 13

çmimet bazuar në ofertën paraprake të bërë nga kompania “Elektring” Shpk. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se informatat/sqarimet e dhëna nga OE N.SH”MVR Elektromontues” nuk janë bindëse dhe nuk janë konform nenit 61 të LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët). Marrëveshja dhe deklarata e prezantuar nuk ofrojnë ndonjë dëshmi bindëse për artikujt e ofruar me 0.10 €, dhe në këtë marrëveshje nuk ka ndonjë listë të çmimeve të ofruara as edhe ndonjë analizë lidhur me ekonominë e procesit të prodhimitarisë, fatura të furnizimeve, apo edhe dëshmi tjera siç e përcakton neni 61 i LPP-së. Disa prej çmimeve jo normalisht të ulëta janë:

- Pozicioni 10 i kategorisë A “Porosia dhe montimi i relesë IC ASTRO Shneider, Siemens, ABB ose e ngjashme ekuivalent” që nga OE N.SH”MVR Elektromontues” është ofruar me 0.10€, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 110.00 €.
- Pozicioni 4 i kategorisë B “ Furnizimi dhe montimi I trupit ndriçues REMO 400 me gjashtë poça GX 53 për montim në shesh te njëjta me ato ekzistuese” që nga OE N.SH”MVR Elektromontues” është ofruar me 0.10 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 190.00 €. Pozicioni 9 i kategorisë B” Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m, sipas porosisë së organit mbikëqyrës” që nga OE N.SH”MVR Elektromontues” është ofruar me 1.00 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 90.00€. por Paneli Shqyrtues sqaron për këtë pike pretenduese kemi vendimin e OSHP-se, vendimin PSH nr.590/19 te datës 13.11.2019 i cili nder te tjera sqaron se kur kemi kriterin çmimi me i lire i poentuar duhet te eliminohet nga praktika kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e një ofertuesi tjetër, pasi qe kriteri i tille kërkon qe çmimet e poentuar te bazohen ne çmimet e ofruara, e jo duke u bazuar me çmimet e ofertuesve te tjerë, sepse ne rast se kemi te bëjmë me krahasimin e çmimeve te ofertave te ndryshme me njëra tjetrën atëherë kemi te bëjmë me kriterin çmimi me i ulët dhe gjen zbatim rregullorja për tenderët jo normalisht te ulët. Paneli shqyrtues sqaron se Neni 52 .6 i LPP-se përcakton: Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet, **çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm.**

Paneli shqyrtues sqaron se ne rastin e kriterit çmimi me i lire i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimi me çmime pasi qe sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës se dhënë. P.sh nëse pesha është dhënë kategorive te artikujve apo shërbimeve duke u

bazuar ne raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj ne mënyrë të qarte se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-ës, kjo ne baze të interpretimit të KRPP-se të datë s 10.12.2019 tek pyetjet e shpeshta , pyetja nr. 68. **Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.**

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Vushtrri
- 1x1 OE- : NNP "ELEKTRO"
- 1x1 OE: N.SH. "MVR Elektromontues"-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.